



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRI I FINANCAVE
KABINETI

Nr. 17804/2 Prot.

Tiranë, më 14.01.2013

U R D H Ë R

Nr. 1 Datë 14.01.2013

Për

**shpalljen e disa ndryshimeve të ndodhura gjatë vitit 2010 në disa standardeve
ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF)**

Në mbështetje të nenit nr. 4, pika 3, të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, i ndryshuar, të VKM nr. 672, datë 26.10.2005 “Për miratimin e rregullores së brendëshme të organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dhe sipas Vendimit nr. 3, datë 24.10.2012 të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit,

U R D H E R O J

1. Shpalljen për zbatim të disa ndryshimeve të ndodhura gjatë vitit 2012 në disa standarde ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF), të hartuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, dhe të përkthyer në shqip nga gjuha angleze nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, si më poshtë:
 - Ndryshime në Standardi të Raportimit Financiar (SNRF) nr. 10, nr. 11, nr. 12.
 - Ndryshime në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) nr. 1, Huatë qeveritare.
 - Ndryshime në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) nr. 1, Adoptimi për here të pare I SNRF-ve.Tekstet e të cilave janë bashkëlidhur këtij Urdhëri dhe janë pjesë integrale e tij.
2. Njësitë ekonomike, të cilat sipas parashikimeve të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për Kontabilitetin dhe Raportimin Financiar”, i ndryshuar, janë të detyruara të zbatojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar, të aplikojnë ndryshimet si në pikën 1 të këtij Urdhëri, duke filluar nga muaji janar 2013.
3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen internetit të Ministrisë së Financave dhe në atë të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.

Ridvan BODE

MINISTÈR